




Ambasciata d'Italia
Tirana



unicef
for every child

UDHËZUES PËR IDENTIFIKIMIN DHE REFERIMIN E RASTEVE TË RINJVE NEET (GRUPMOSHA 15-18 VJEÇ) NË ARSIM, FORMIM PROFESIONAL, TRAJNIM APO PUNËSIM NGA AKTORËT VENDORË



MAJ 2024

UDHËZUES PËR IDENTIFIKIMIN DHE REFERIMIN E RASTEVE TË TË RINJVE NEET NË ARSIM, FORMIM PROFESIONAL, TRAJNIM APO PUNËSIM NGA AKTORËT VENDORË (me fokus të rinjtë 15-18 vjeç)

Ky Dokument u përgatit nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve në zbatim të programit "Reaching the Unreached 2", në kuadër të projektit "QENDRO në shkollë" financuar nga qeveria italiane nëpërmjet Ambasadës Italiane në Tiranë dhe zbatuar nga UNICEF.

Të gjitha të drejtat për këtë Dokument, përfshirë të drejtat e autorit, janë në pronësi të Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve dhe mbrohen nga ligjet e zbatueshme të Republikës së Shqipërisë dhe ato ndërkombëtare. Ky Dokument nuk mund të kopjohet, të ndahet, të përkthehet në një gjuhë tjetër, apo të përshtatet pa leje paraprake nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Informacioni dhe pikëpamjet e shprehura në këtë Dokument janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë medoemos opinionin zyrtar të UNICEF-it, si dhe Ambasadës Italiane në Tiranë.

Tabela e Përmbajtjes

AKRONIMET	4
HYRJE	5
I. PARTNERËT E MUNDSHËM NË NIVEL LOKAL QË MUND TË IDENTIFIKOJNË NEET	8
1.1 IDENTIFIKIMI I TË RINJVE NEET (grupmosha 15-18 vjeç)	9
1.2 INSTITUCIONET E MUNDSHME PËR IDENTIFIKIMIN E NEET	10
1.2.1 Zyra e Punës	10
1.2.2 Këshilli Vendor Rinor (KVR)	11
1.2.3 Tabela e Përmbajtjes	13
1.2.4 Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar (DRAP)	14
1.2.5 Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVAP)	15
1.2.6 Institucionet arsimore publike dhe private	16
1.2.7 Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik (DRFPP)	17
1.2.8 Zyra Vendore e Formimit Profesional (ZVFP)	17
1.2.9 Qendra multifunksionale e Aftësisimit dhe Formimit Profesional	18
1.2.10 Inspektorati i Punës	18
1.2.11 Aktorë të tjerë	19
II. MEKANIZMAT NË NIVEL LOKAL PËR MENAXHIMIN E RASTEVE NEET	20
2.1 MENAXHIMI I RASTEVE TË TË RINJVE NEET	21
2.1.1 Takime ndërinstitucionale për bashkërendimin e punës	21
2.1.2 Intervistat individuale me NEET	21
2.1.3 Vezhgimet në terren	22
2.2 KOORDINIMI NDËRMJET AKTORËVE LOKAL PËR IDENTIFIKIMIN E TË RINJVE NEET	22
2.3 KOORDINIMI ME AKTORË TË JASHTËM	24
2.4 SHËRBIMET MBËSHTETËSE PËR TË RINJTË NEET	25

AKRONIMET

AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
DRAP	Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar
DRFPP	Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik
NjA	Njësi Administrative
NEET	Të rinjtë jo në arsim, punësim ose trajnim
NjMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës
NJVV	Njësia e Vetëqeverisjes Vendore
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
SHPS	Shërbimi Psikosocial
ZVAP	Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar
ZVFP	Zyra Vendore e Formimit Profesional

HYRJE

Në Shqipëri nuk ka një përcaktim ligjor të të rinjve NEET¹, megjithatë, në dokumenta zyrtare, nënkuptohet se i referohet të rinjve 15-29 vjeç, jo në punësim, arsim ose trajnim. Gjatë vitit 2022, sipas të dhënave të Institutit të Statistikave, Shqipëria kishte 601,622 të rinj 15-29 vjeç, që përbënin 22% të popullsisë së përgjithshme. Megjithatë, vërehet një prirje shqetësuese, pasi 25.2% e kësaj rinie më saktë 151,609 individë, i përkasin kategorisë NEET.

Faktorët që ndikojnë në krijimin e kësaj kategorie², lidhen me fenomenin e braktisjes apo mospjesëmarrjes në arsim, nivelin e ulët të besimit në sistemin e aftësimin profesional, vështirësi aksesit në tregun e punës nga mospërputhja e ofertës me kërkesën, emigracioni dhe vështirësitë e ri-integrimit të migrantëve të kthyer si dhe mungesa e informacionit rreth mundësive, programeve dhe kanaleve për rintegrim në edukim, aftësim apo të ndërmjetësimit në tregun e punës.

Gjatë 4 viteve të fundit 2019 – 2022 ka një ulje të normës NEET me 1.4%, duke arritur në 25.2% në 2022 krahasuar me 26.6% në 2019. Pavarësisht këtij progresi, norma NEET mbetet mjaft e lartë pothuajse dyfishi i normës NEET (13.1%³) në Bashkimin Europian dhe evidenton nevojën e domosdoshme për inkurajimin e hartimit të politikave të sukseshme, për zbatimin efektiv të strategjive dhe politikave ekzistuese, përmirësimin e sistemit arsimor, rritjen e aksesit në tregun e punës dhe zhvillimin e aftësive, informimin dhe ndërgjegjësimin e të rinjve rreth mundësive, programeve, platformave që ofrohen për rintegrimin e tyre si dhe për bashkimin e të gjitha përpjekjeve institucionale dhe komunitare të të gjithë aktorëve për të përmirësuar statusin e këtyre rinjve në shoqëri.

Referuar praktikës së suksesshme të ndërtuar nga UNICEF-Shqipëri në partneritet me **Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve** (Observatori) për evidentimin e fëmijëve në rrezik braktisje shkolle (niveli i arsimit bazë), Observatori **pilotoi ngritjen e një praktike pune për**

1 Term në anglisht "Neither in Education, Employment or Training" (NEET)

2 Study on Youth Employment in Albania, Regional Cooperation Council financuar nga Bashkimi Europian

3 EUROSTAT 2022

identifikimin dhe menaxhimin e të rinjve NEET në nivel lokal, në bashkinë e Elbasanit, në periudhën Shtator 2023-Dhjetor 2024. Komponentët kryesorë në të cilat u pilotua ngritja e praktikës së punës ishin:

1. Krijimi dhe konsolidimi i Grupit Koordinues Lokal për NEET në Elbasan. Ngritja e këtij grupi koordinues në nivel vendor pranë zyrës së Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësit dhe Aftësive (DR-AKPA) filloi me pjesëmarrjen e disa prej përfaqësuesve në nivel vendor të cilët përfshinin arsimin dhe mbrotjen sociale. Takim pas takimi, lindte nevoja që ky grup të zgjerohej dhe me aktore të tjerë vendore, duke bërë që deri më sot, pjesë e këtij grupi koordinues lokal për NEET të jenë:

- Arsimi, të cilët në këtë grupim përfaqësohen nga:
 - zyra arsimore vendore
 - drejtues të shkollave që kanë arsim bazë me kohë të pjesëshme (ABKP) dhe gjimnazi me kohë të pjesëshme (GJKP)
 - pedagogu për orientim karriere, pjesë e Universitetit të Elbasanit.
 - mësues të shkollës/ve të mesme, kryesisht ato që merren me orintim karriere

- Mbrojtja sociale, ku është punonjësi për mbrojtjen e fëmijëve (PMF), pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijëve (NJMF) në bashkinë Elbasan;

- Përfaqësues nga Zyra e punës pranë Bashkisë Elbasan

- DR-AKPA, i cili është dhe institucioni që fton, organizon takimet në ambientet e tyre dhe koordinon proceset rast pas rasti.

- Qendra e Formimit Profesional (QFP), Elbasan, të cilët ofrojnë kurset dhe trajnimet kualifikuese për persona mbi 15 vjeç, duke përcaktuar dhe evidentuar kriteret përkatëse sipas kushteve dhe interesave të personave NEET.

- Inspektoriat Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHP-

SHSH) - agjenci vendore e rëndësishme për të evidentuar të gjithë detyrimet Ligjore dhe hapësirat e mundshme, në rast interesi për punësim personi mbi 16 vjeç dhe nën 18 vjeç.

- Organizata të shoqërisë civile të angazhuar në nivel vendor për çështjet e të rinjve dhe punësimin;
- Përfaqësues rinor nga dy këshillat vendor në Elbasan që janë:
 - Këshillit Vendor Rinor (KVR)
 - Këshillin Rinor (KR-E)
- Specialisti/ punonjësi i rinisë pranë Bashkisë Elbasan

Qëllimi i krijimit të këtij grupi është identifikimi dhe mbështetja e të rinjve, të cilët nuk kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm dhe ata që nuk janë as në arsim, trajnim profesional apo punësim, duke i referuar këto raste në arsimin e mesëm apo qendrat e formimit profesional.

2. Konsolidimi i Grupit Koordinues Lokal për NEET

Që prej themelimit të tij, grupi u formalizua në mënyrë zyrtare duke identifikuar një person kontakti nga secili institucion pjesëmarrës, me qëllim lehtësimin e komunikimit ndërmjet institucioneve vendore, reduktimin e burokracive dhe zbatimin e afateve kohore.

Grupi Koordinues Lokal për NEET në Elbasan, është mbledhur periodikisht, duke shkëmbyer informacion për identifikimin dhe ndërmarrjen e veprimeve për të përmbushur nevojat e të rinjve NEET.

Referuar praktikës së deritanishme të ndjekur nga **Grupit Koordinues Lokal për NEET** në Elbasan, dhe nevojave të identifikuara në terren, është hartuar ky udhëzues, që ka dy shtylla kryesore:

1. Së pari, **identifikimin e partnerëve të mundshëm në nivel lokal** që mund të identifikojnë NEET, duke detajuar rolet dhe përgjegjësitë e secilit
2. Së dyti, **mekanizmat në nivel lokal për menaxhimin e rasteve NEET**

I. PARTNERËT E MUNDSHËM NË NIVEL LOKAL QË MUND TË IDENTIFIKOJNË NEET



1.1 IDENTIFIKIMI I TË RINJVE NEET (grupmosha 15-18 vjeç)

Instituti i Statistikave (INSTAT) jep një përkufizimi të treguesit NEET, i cili është ndër treguesit e matur nga ky institucion që prej vitit 2010. Ky përkufizim⁴ është:

Treguesi për të rinjtë as në punësim, as në arsim dhe trajnim, shkurtimisht (NEET) korrespondon me përqindjen e popullsisë së një grupi të një moshe dhe gjinie të caktuar, të cilët nuk janë të punësuar dhe nuk janë të përfshirë në arsim apo në ndonjë trajnim të mëtejshëm. Ky tregues i referohet personave që i plotësojnë këto dy kushte:

- ata nuk janë të punësuar (dmth të papunë ose joaktiv sipas definicionit të Organizatës Ndërkombëtare e Punës);
- ata nuk kanë marrë asnjë edukim apo trajnim në katër javë përpara vrojtimit. Emëruesi është popullsia e përgjithshme e së njëjtës grupmoshe dhe gjinie, me përjashtim të të anketuarve të cilët nuk janë përgjigjur pyetjes 'pjesëmarrjes në arsim dhe trajnim të rregullt

Të dhënat e INSTAT përfshijnë përqindjen e individëve të rinj NEET të kategorizuar sipas dy grupmoshave (15-24 dhe 15-29), gjinisë dhe nivelit arsimor. Për fat të keq, ka një mungesë informacioni për të rinjtë NEET që nuk janë aktualisht të regjistruar në arsim ose trajnime, të ndara më tej sipas moshës dhe gjinisë⁵. Për më tepër të dhënat janë vetëm në nivel kombëtar dhe identifikimi i këtyre të rinjve në termat e shtrirjes gjeografike (nivel rajonal apo lokal) brenda territorit shqiptar apo karakteristikave social-ekonomik është i pamundur me të dhënat publike që disponohen. Kjo e bën të vështirë jo vetëm hartimin e politikave të suksesshme për ta, por bën të pamundur identifikimin dhe zbatimin e ndërhyrjeve specifike dhe individuale për të përmirësuar statusin e tyre.

⁴ Fjalori terminologjik, INSTAT

⁵ Tregu i punës 2022, INSTAT

1.2 INSTITUCIONET E MUNDSHME PËR IDENTIFIKIMIN E NEET

Identifikimi i të rinjve NEET është një sfidë komplekse që kërkon përfshirjen e aktorëve të shumtë në nivel lokal, që përfaqësojnë institucionet publike por edhe organizatat e shoqërisë civile (OshC), si dhe sektori privat. Nga puna në terren në zonën e Elbasanit, aktorët kryesorë të mundshëm që mund të identifikojnë NEET në nivel lokal, evidentohet të jenë:

1.2.1 Zyra e Punës

Zyra e Punës ka një rol të rëndësishëm dhe strategjik në identifikimin dhe mbështetjen e të rinjve NEET. Si një ndërmjetës kryesor mes të rinjve dhe tregut të punës, Zyra e Punës është e përfshirë në disa aspekte kyçe të procesit të identifikimit dhe integritit të këtyre të rinjve në shoqëri. Detyrat kryesore të Zyrës së Punës në identifikimin e të rinjve NEET përfshijnë:

- **Regjistrimi dhe Mbledhja e Informacionit:** Zyra e Punës regjistron të rinjtë që aplikojnë për shërbimet e saj dhe mban një bazë të dhënash të detajuar mbi statusin e tyre në arsim, punësim dhe trajnim. Këto të dhëna ndihmojnë në identifikimin e të rinjve NEET dhe në përcaktimin e nevojave të tyre specifike për mbështetje.
- **Konsultimi dhe Vlerësimi i Nevojave:** Përmes konsultimeve individuale, Zyra e Punës vlerëson situatën e secilit të ri NEET, duke marrë parasysh arsimin e mëparshëm, përvojën e punës, dhe çdo pengesë që mund të kenë për integrimin në tregun e punës ose në trajnim. Ky vlerësim është i rëndësishëm për të zhvilluar një plan të personalizuar për secilin individ.
- **Koordinimi me Institucione dhe Organizata të Tjera:** Zyra e Punës bashkëpunon me shkolla, organizata rinore, institucione arsimore, dhe organizata të tjera për të identifikuar të rinjtë NEET dhe për të ofruar mbështetje të koordinuar. Ky bashkëpunim mund të përfshijë shkëmbimin e informacionit dhe krijimin e programeve të për-

bashkëta për trajnim dhe punësim.

- Ofrimi i Shërbimeve të Këshillimit dhe Trajnimit: Zyra e Punës ofron shërbime këshillimi dhe trajnimi për të rinjtë NEET, duke i ndihmuar ata të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për të hyrë në tregun e punës ose për të ndjekur programe arsimore. Këto shërbime përfshijnë gjithashtu udhëzime për hartimin e CV-së, përgatitje për intervista, dhe zhvillimin e aftësive të buta.
- Referimi dhe Ndërlidhja me Punëdhënësit: Zyra e Punës luan një rol kyç në lidhjen e të rinjve NEET me punëdhënësit e mundshëm. Ajo ndërmjetëson mes të rinjve dhe biznesit për të siguruar që të rinjtë të kenë mundësi punësimi që janë të përshtatshme për aftësitë dhe interesat e tyre. Kjo përfshin gjithashtu organizimin e panairove të punës dhe të ngjarjeve të tjera të rrjetëzimit.
- Monitorimi dhe Vlerësimi i Progresit: Pas referimit të një të riu NEET në një program pune ose trajnimi, Zyra e Punës monitoron progresin e tyre për të siguruar që ata janë duke përfituar nga shërbimet dhe për të bërë ndërhyrje të mëtejshme nëse është e nevojshme. Ky monitorim ndihmon në mbajtjen e statistikave të sakta dhe në përshtatjen e programeve për të përmbushur më mirë nevojat e të rinjve.
- Promovimi i Mundësive dhe Programeve: Zyra e Punës promovon aktivisht mundësitë për punësim dhe trajnim për të rinjtë NEET përmes fushatave të informimit, mediat sociale, dhe bashkëpunimeve me institucione dhe organizata të tjera. Qëllimi është që të rinjtë të jenë të informuar për mundësitë që ekzistojnë dhe të ndihmohen në mënyrën më të mirë për të hyrë në to.

1.2.2 Këshilli Vendor Rinor (KVR)

- » KVR luan një rol të rëndësishëm në identifikimin e të rinjve NEET në komunitetin lokal. Ky këshill, duke qenë i lidhur ngushtë me të rinjtë dhe duke kuptuar sfidat me të cilat përballen, është në gjendje të

ndihmojë në identifikimin e tyre përmes aktiviteteve dhe kontakteve të drejtpërdrejta. Përveç kësaj, Këshilli mund të organizojë kampanja ndërgjegjësuese, sondazhe dhe takime me të rinjtë për të identifikuar ata që janë në rrezik ose që tashmë janë jashtë sistemit arsimor dhe të punës. Në bashkëpunim me autoritetet lokale dhe Zyrat e Punësimit, KVR mund të ndihmojë në referimin e këtyre të rinjve për mbështetje të mëtejshme dhe integrim në programe të përshtatshme aftësimi dhe punësimi. Detyrat kryesore të Këshillit Vendor Rinor në identifikimin e të rinjve NEET përfshijnë:

- Ndërmjetësimi midis të rinjve dhe institucioneve lokale: KVR funksionon si një urë komunikimi mes të rinjve dhe institucioneve publike, duke përcjellë nevojat, sfidat dhe shqetësimet e të rinjve NEET te autoritetet përkatëse. Nëpërmjet aktiviteteve dhe kontakteve të drejtpërdrejta, Këshilli identifikon të rinjtë që kanë nevojë për ndihmë dhe i drejton ata tek shërbimet dhe programet mbështetëse të Bashkisë.
- Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe informuese: Këshilli organizon aktivitete në komunitet për të rritur ndërgjegjësimin lidhur me sfidat dhe mundësitë që lidhen me punësimin dhe arsimin. Këto aktivitete, si seminare, tryeza të rrumbullakëta, apo ditë informuese, ndihmojnë në identifikimin e të rinjve NEET dhe në ndërgjegjësimin e tyre për mundësitë që ekzistojnë.
- Zhvillimi i anketave dhe sondazheve lokale: KVR kryen anketime dhe sondazhe në bashkëpunim me Bashkinë dhe organizata të tjera për të mbledhur të dhëna mbi situatën e të rinjve në komunitet. Këto të dhëna ndihmojnë në identifikimin e të rinjve që janë jashtë sistemit arsimor dhe të punës, dhe ofrojnë një bazë për planifikimin e ndërhyrjeve të mëtejshme.
- Rrjetëzimi dhe bashkëpunimi me organizatat rinore dhe shkollat: Këshilli ka një rrjet të gjerë kontakti me organizata rinore, shkollat dhe grupe të tjera komunitare, që lejon identifikimin e hershëm të të rinjve NEET dhe referimin e tyre tek shërbimet përkatëse. Bashkëpunimi me këto entitete ndihmon në krijimin e një sistemi të

koordinuar për identifikimin dhe mbështetjen e të rinjve në nevojë.

- Mbështetja e integritit social dhe profesional: Pas identifikimit të të rinjve NEET, KVR punon për të ndihmuar në integrimin e tyre në programet arsimore, trajnuese ose punësimi. Këshilli luan një rol mbështetës, duke ofruar këshillim dhe udhëzime, si dhe duke ndihmuar në qasjen e këtyre të rinjve në shërbimet e Bashkisë dhe organizatave të tjera.
- Monitorimi dhe raportimi: Këshilli Vendor Rinor është përgjegjës për mbajtjen e statistikave dhe raportimin mbi progresin e të rinjve NEET në Bashki. Ky monitorim siguron që ndërhyrjet dhe politikat e zbatuara janë efektive dhe që të rinjtë e identifikuar marrin mbështetjen e nevojshme.

1.2.3 Punonjësi Rinor në Bashki

» Punonjësi Rinor në Bashki ka një rol thelbësor në identifikimin dhe mbështetjen e të rinjve NEET (të rinj që nuk janë në arsim, punësim ose trajnim). Duke qenë pjesë e strukturave lokale dhe duke pasur një lidhje të ngushtë me komunitetin, Punonjësi Rinor ka aftësinë të identifikojë nevojat dhe sfidat me të cilat përballen të rinjtë që janë jashtë sistemit arsimor dhe të punës. Detyrat kryesore të Punonjësit Rinor në identifikimin e të rinjve NEET përfshijnë:

- Mbledhja e Informacionit: Punonjësi Rinor përdor rrjete lokale dhe kontakte të drejtpërdrejta me të rinjtë dhe familjet e tyre për të mbledhur informacion mbi ata që nuk janë të angazhuar në arsim, punësim ose trajnim. Kjo përfshin bashkëpunimin me shkolla, organizata rinore dhe institucione të tjera për të identifikuar të rinjtë në rrezik të daljes nga këto sisteme.
- Ndërgjegjësimi dhe Aktivitetet në Komunitet: Punonjësi Rinor organizon aktivitete dhe fushata ndërgjegjësuese në komunitet për të tërhequr vëmendjen mbi mundësitë e edukimit dhe punësimit për të rinjtë. Këto aktivitete ndihmojnë në identifikimin e të rinjve NEET duke krijuar një ambient të hapur dhe të besueshëm ku ata mund të ndajnë sfidat e tyre.

- Konsultimet dhe Takimet e Drejtpërdrejta: Punonjësi Rinor organizon takime dhe konsultime me të rinjtë për të kuptuar situatën e tyre dhe për të ofruar këshilla dhe udhëzime për mundësitë që ekzistojnë në fushën e arsimit dhe punësimit. Këto takime ndihmojnë në krijimin e një profili të qartë të të rinjve NEET dhe në identifikimin e shkaqeve që i kanë çuar ata në këtë situatë.
- Koordinimi me Shërbimet e Tjera: Punonjësi Rinor bashkëpunon ngushtë me Zyrat e Punës, shërbimet sociale dhe institucionet arsimore për të ndihmuar në krijimin e një plani ndërhyrjeje për të rinjtë NEET. Ky koordinim përfshin referimin e tyre në programe trajnuese, punësimi ose mbështetje sociale, në varësi të nevojave të identifikuara.
- Raportimi dhe Monitorimi: Punonjësi Rinor është përgjegjës për mbajtjen e shënimeve dhe raportimin e progresit të të rinjve NEET në bashki. Ai ose ajo monitoron vazhdimisht situatën e tyre për të siguruar që ndërhyrjet e bëra janë efektive dhe për të përshtatur strategjitë e mbështetjes sipas nevojës.

1.2.4 Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar (DRAP)

» DRAP janë 4 drejtori rajonale të arsimit parauniversitar, në Lezhë, Durrës, Korçë dhe Fier. DRAP ka një rol kyç në identifikimin e të rinjve NEET, duke përfshirë disa detyra dhe përgjegjësi kryesore:

- *Identifikimi dhe Monitorimi:* DRAP ka përgjegjësinë të identifikojë të rinjtë që janë jashtë sistemit arsimor, të papunë dhe që nuk ndjekin trajnim profesional. Kjo përfshin grumbullimin dhe analizimin e të dhënave nga shkollat, zyrat e punësimit, dhe institucionet e tjera relevante.
- *Bashkëpunimi me Institucione të Tjera:* DRAP bashkëpunon me institucione të tjera shtetërore dhe organizata joqeveritare për të ndihmuar në identifikimin dhe mbështetjen e të rinjve NEET. Këto institucione përfshijnë zyrat e punësimit, qendrat e trajnimit profe-

sional, dhe organizatat e shoqërisë civile.

- *Programet e Riintegritimit:* DRAP është përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e programeve që synojnë riintegrimin e të rinjve NEET në sistemin arsimor ose tregun e punës. Kjo mund të përfshijë programe arsimore të arsimimit me kohë të pjesshme, kurse trajnimi profesional, ose programe mentorimi.

1.2.5 Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVAP)

» ZVAP janë 61 zyra në çdo bashki që janë përgjegjëse për monitorimin, vlerësimin dhe inspektimin; planifikimin e buxhetit të shkollave; mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore; zbatimin e kurrikulës dhe standardeve; ofrimin e asistencës teknike në shkolla, punësimin e mësuesve dhe bashkërendimin me autoritetet vendore. ZVAP ka një rol kyç në identifikimin e të rinjve NEET, duke përfshirë disa detyra dhe përgjegjësi kryesore:

- *Identifikimi i të Rinjve NEET:* ZVAP është përgjegjëse për grumbullimin e të dhënave nga shkollat dhe institucionet e tjera arsimore në nivel lokal për të identifikuar të rinjtë që janë jashtë sistemit arsimor, të papunë dhe që nuk ndjekin trajnim profesional. Ky proces përfshin monitorimin e të dhënave të regjistrimit dhe të largimit nga shkolla.
- *Bashkëpunimi me Institucione të Tjera Lokale:* ZVAP bashkëpunon me zyrat lokale të punësimit, qendrat e trajnimit profesional, dhe organizatat joqeveritare për të identifikuar dhe mbështetur të rinjtë NEET. Ky bashkëpunim ndihmon në shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin e përpjekjeve për t'u ofruar mbështetje të rinjve.
- *Programet e Ndërhyrjes dhe Mbështetjes:* ZVAP zhvillon dhe zbaton programe ndërhyrjeje për të rinjtë NEET në nivel lokal. Këto programe mund të përfshijnë kurse të rikthimit në shkollë, trajnime profesionale, ose programe mentorimi dhe këshillimi.

1.2.6 Institucionet arsimore publike dhe private

» Roli i shkollës në identifikimin dhe mbështetjen e të rinjve NEET është shumë i rëndësishëm dhe përfshin disa aspekte kryesore:

- *Monitorimi i Prezencës dhe Performancës së Nxënësve:* Mësuesit dhe stafi administrativ kanë përgjegjësinë për të monitoruar vazhdimisht praninë e nxënësve në shkollë. Nxënësit që mungojnë shpesh ose që largohen nga shkolla janë në rrezik të bëhen NEET dhe duhet të identifikohen herët.
- *Komunikimi me Prindërit dhe Kujdestarët:* Shkolla duhet të mbajë një komunikim të vazhdueshëm me prindërit ose kujdestarët e nxënësve për të diskutuar mbi përparimin e tyre akademik dhe çështje të tjera që mund të ndikojnë në pjesëmarrjen e tyre në arsim. Kjo ndihmon në zbulimin e problemeve të mundshme që mund të çojnë në largimin nga shkolla.
- *Këshillimi dhe Mbështetja Psikosociale:* Shkolla në saj të Njësisë së Shërbimit Psikosocial SHPS ofron shërbime këshillimi për nxënësit që kanë vështirësi akademike, sociale ose emocionale. Punonjësit e SHPS shkollorë mund të luajnë një rol të rëndësishëm në identifikimin e nxënësve që janë në rrezik të bëhen NEET dhe në ofrimin e mbështetjes së nevojshme.
- *Programet e Asistencës/ Ndhmës Akademike:* Shkollat mund të organizojnë programe ndihme akademike për nxënësit që kanë vështirësi në mësim, për të parandaluar largimin e tyre nga shkolla. Këto programe mund të përfshijnë kurse përgatitore, mësim shtesë etj.
- *Bashkëpunimi me Institucione të Tjera:* Shkollat bashkëpunojnë me ZVAP, qendrat e trajnimit profesional, zyrat e punësimit dhe organizatat joqeveritare për të identifikuar dhe mbështetur të rinjtë NEET.

1.2.7 Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik (DRFPP)

» DRFPP janë 12 drejtori rajonale që kanë kompetenca territoriale në zonën e vendbanimit të personit apo selisë/degës së punëdhënësit, i cili pretendon të përfitojë nga një ose disa shërbime apo programe të ofruara nga kjo strukturë. Roli i DRFPP në identifikimin dhe mbështetjen e të rinjve NEET është shumë i rëndësishëm dhe përfshin disa aspekte kryesore:

- *Grumbullimi i Të Dhënave dhe Monitorimi:* DRFPP ka përgjegjësinë për të grumbulluar dhe analizuar të dhëna nga qendrat e formimit profesional dhe institucionet e tjera relevante për të identifikuar të rinjtë që nuk janë të përfshirë në arsim, punësim ose trajnim. Ky proces përfshin monitorimin e regjistrimeve në programe trajnimi dhe analizimin e statistikave për të rinjtë që përfundojnë ose braktisin këto programe.
- *Bashkëpunimi me Institucione të Tjera:* DRFPP bashkëpunon me institucione të tjera shtetërore dhe organizata joqeveritare për të identifikuar dhe mbështetur të rinjtë NEET. Ky bashkëpunim përfshin shkëmbimin e informacionit me Zyren Vendore të Arsimit Parauniversitar, zyrat e punësimit, dhe shkollat për të siguruar që të gjithë të rinjtë në nevojë të identifikohen dhe të mbështeten.
- *Zhvillimi dhe Zbatimi i Programeve të Trajnimit:* Një nga përgjegjësitë kryesore të DRFPP është zhvillimi dhe zbatimi i programeve të trajnimit profesional që janë të përshtatshme për të rinjtë NEET. Këto programe synojnë të pajisin të rinjtë me aftësi të reja dhe të rrisin mundësitë e tyre për punësim.

1.2.8 Zyra Vendore e Formimit Profesional (ZVFP)

» Zyrat Vendore të Formimit Profesional (ZVFP) janë 10 zyra vendore që kanë kompetenca territoriale në zonën e vendbanimit të personit apo selisë/degës së punëdhënësit, i cili pretendon të përfitojë nga një ose disa shërbime apo programe të ofruara nga kjo strukturë.

1.2.9 Qendra multifunktionale e Aftësimit dhe Formimit Profesional

» Qendrat multifunktionale të Aftësimit dhe Formimit Profesional janë të fokusuara në ofrimin e trajnimeve profesionale dhe shërbimeve mbështetëse për të ndihmuar të rinjtë të integrohen në tregun e punës dhe në sistemin arsimor. Roli i tyre përfshin disa përgjegjësi kyçe:

- *Programe të Personalizuara të Trajnimit:* Qendrat multifunktionale të Aftësimit dhe Formimit Profesional zhvillon programe të personalizuara të trajnimit profesional që janë të përshtatshme për nevojat dhe interesat e të rinjve NEET, duke i pajisur ata me aftësi praktike dhe të kërkuara në tregun e punës.
- *Kurse Kualifikimi dhe Rikualifikimi:* Qendra ofron kurse të ndryshme kualifikimi dhe rikualifikimi për të ndihmuar të rinjtë të përmirësojnë aftësitë e tyre dhe të përgatiten për mundësitë e reja të punësimit.

1.2.10 Inspektoriati i Punës

» Inspektoriati i Punës në Shqipëri luan një rol të rëndësishëm në identifikimin dhe mbështetjen e të rinjve NEET duke përfshirë disa detyra dhe përgjegjësi kyçe:

- *Inspektimet në Vendet e Punës:* Inspektoriati i Punës kryen inspektime në vendet e punës për të siguruar që ligjet e punës janë duke u respektuar dhe për të identifikuar çdo abuzim ose shkelje që mund të ndikojë negativisht tek të rinjtë. Gjatë këtyre inspektimeve, inspektorët mund të identifikojnë të rinjtë që janë të punësuar në mënyrë joformale ose që kanë nevojë për mbështetje shtesë për të qëndruar në punë.
- *Bashkëpunimi me Institucione të Tjera:* Inspektoriati i Punës bashkëpunon me zyrat e punësimit, shkollat, qendrat e formimit profesional dhe organizatat joqeveritare për të shkëmbyer informacion dhe për të identifikuar të rinjtë NEET. Kjo ndihmon në krijimin e një

baze të dhënash të përbashkët për të rinjtë që kanë nevojë për mbështetje.

- *Hetimi i Punësimit Joformal*: Inspektorati i Punës heton rastet e punësimit joformal, ku të rinjtë mund të jenë të punësuar pa kontratë ose në kushte të padrejta. Identifikimi i këtyre rasteve ndihmon në mbrojtjen e të rinjve dhe në sigurimin e kushteve të drejta të punësimit për ta.

1.2.11 Aktorë të tjerë

- » **Organizatat e Shoqërisë Civile (OShC)** ku përfshihen të gjitha organizatat që kanë si qëllim zbatimin e projekteve dhe aktivitete në ndihmë të të rinjve për zhvillimin e tyre personal dhe profesional. Këtu përfshihen edhe organizata të specializuara në trajnime të aftësive, këshillimi profesional dhe mentorim për të rinjtë.
- » **Sektori Privat** (bizneset dhe ndërmarrjet) mund të ofrojë mundësi punësimi, praktika pune, trajnime dhe programe të tjera për të rinjtë. Po aq të rëndësishme janë edhe Agjencitë e Punësimit si ndërmjetësues për aksesin e të rinjve në tregun e punës.

II. MEKANIZMAT NË NIVEL LOKAL PËR MENAXHIMIN E RASTEVE NEET



2.1 MENAXHIMI I RASTEVE TË TË RINJVE NEET

Menaxhimi i rasteve të individëve NEET është një proces i rëndësishëm që kërkon angazhimin e të gjithë aktorëve, jo vetëm të institucioneve përgjegjëse për arsim, aftësim dhe punësim, por dhe të entiteteve të tjera private dhe komunitare që ofrojnë shërbime mbështetëse për këtë kategori dhe prodhojnë dhe pilotojnë skema për ri-integrimin e të rinjve në sistemin e edukimit, në tregun e punës apo mundësive për zhvillimin e aftësive. Vlerësimi i nevojave të të rinjve NEET si dhe menaxhimi i rasteve të identifikuar, duhet të realizohet nëpërmjet mekanizmave të mëposhtëm:

2.1.1 Takime ndërinstytucionale për bashkërendimin e punës

Në këtë kuadër sugjerohen të zhvillohen takime ndërinstytucionale në nivel lokal. Më poshtë paraqitet mënyra e realizimit të tyre, duke detajuar informacionin rreth institucionit që duhet të koordinojë, periudhës, pjesëmarrësve dhe qëllimit.

Takime ndërinstytucionale në nivel lokal

Institucioni që koordinon	Periudha	Pjesëmarrës	Qëllimi
ZVAP	Brenda muajit Nëntor	AKPA, NJMF dhe drejtorja e policisë në nivel vendor	Bashkërendimi i punës për menaxhimin e këtyre rasteve për tu integruar në shkollë, ose punësim, ose trajnim, ose kualifikim.

2.1.2 Intervistat individuale me NEET

Intervistat individuale me NEET, të cilat realizohen për të kuptuar përvojën, nevojat, dhe qëllimet e tyre, po ashtu edhe intervistat me familjarët e tyre për të kuptuar mjedisin social dhe ekonomik ku jetojnë të rinjtë; si dhe intervista/bisedë e lirë me përfaqësues të institucioneve arsimore që kanë frekuentuar më parë për të kuptuar qasjen e tyre me arsimin si dhe shkaqet që mund të kenë sjellë braktisjen e shkollës ose

mosfrekuentimin. Intervistat duhet të jenë të strukturuar mirë me pyetje dhe formate të caktuara dhe mund të kryhen në grup ose individuale. Përmes intervistave, punonjësit e shërbimeve sociale, ose punonjësit e organizatave qeveritare ose jo-qeveritare mund të marrin informacion të vlefshëm për historinë e jetës, aftësitë, interesat, dhe nevojat e individëve NEET.

2.1.3 Vezhgimet në terren

Vezhgimet në terren janë një mjet i rëndësishëm për të përshkruar dhe kuptuar kontekstin dhe mjedisin në të cilin jetojnë individët NEET. Përmes këtyre vëzhgimeve, ekspertët mund të vlerësojnë karakteristikat e mjedisit (infrastrukturë dhe logjistikë) sjelljen, ndërveprimin social dhe mundësitë e punësimit ose arsimimit në këtë mjedis. Vëzhgimet në terren mund të ofrojnë një perspektivë të plotë dhe të detajuar mbi sfidat dhe mundësitë që përballin individët NEET në jetën e tyre të përditshme.

2.2 KOORDINIMI NDËRMJET AKTORËVE LOKAL PËR IDENTIFIKIMIN E TË RINJVE NEET

Me identifikimin e të rinjve NEET, aktorët lokalë angazhohen në një proces edhe më të vështirë, atë të menaxhimit të rasteve dhe gjetjen e teknikave dhe instrumentave të duhura për rintegrimin e NEET në arsim, aftësim apo punësim. Për të koordinuar sa më mirë këtë proces, propozohen këto hapa:

» **Formimi i Grupit Koordinues Lokal për NEET** që përfshin përfaqësues nga të gjithë institucionet vendore të përfshira në procesin e identifikimit të të rinjve NEET, konkretisht nga:

- *Bashkia*
- *NJMF*
- *ZVAP*
- *Shkolla*
- *AKPA*
- *Qendra e Formimit Profesional*

- *Inspektoriat i Punës*
- *Komisariat i Policisë*
- *Shoqëria Civile*

Ky grup do të ketë përgjegjësinë për koordinimin e aktiviteteve dhe përpilimin e një plani veprues të përbashkët për përpilimin e listave, vlerësimin e nevojave, menaxhimin e rasteve dhe ri-integrimin e të rinjve në arsim, punësim dhe aftësim.

- » **Përcaktimi i personave të kontaktit** për të krijuar një rrjet komuni- kimi ndërmjet institucioneve vendore, që të lehtësojë zhvillimin e këtij procesi, reduktimin e burokracive dhe zbatimin e afateve kohore.
- » **Hartimi i Protokolleve, Formateve dhe Procedurave Standarde** për identifikimin dhe trajtimin e të rinjve NEET, duke përfshirë proceset e identifikimit, vlerësimin e nevojave, dhe drejtimin e tyre drejt shërbimeve të përshtatshme. Këto protokolle jo vetëm lehtësojnë procesin, por krijojnë procedura standarte të veprimit duke siguruar vazhdimësinë dhe periodicitetin e këtij procesi. Është me rëndësi të përcaktohen formatet shkresore, format e regjistrave të të dhënave si dhe dokumentave që do të administrohen nga institucionet përkatëse (pyetësorët, planet individuale të menaxhimit, etj).
- » **Shkëmbimi i Informacionit** nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm të shkëmbimit të informacionit midis aktorëve për identifi- kimin dhe ndërmarrjen e veprimeve për të përmbushur nevojat e të rinjve NEET. Kjo përfshin përcaktimin e llojit të teknologjisë informa- tive që do të përdoret, kalendarët e punës dhe mekanizmat e koor- dinimit të takimeve të rregullta për shkëmbimin e përvojave dhe infor- macionit.
- » **Partneritetet dhe Bashkëpunimi** duhet të përforcohet dhe zg- jerohet me aktorë të tjerë për adresimin më efikas të nevojave dhe zbatimin e iniciativave apo projekteve të reja. Shkëmbimi i informa- cionit dhe eskperiençave, identifikimi dhe adoptimi i praktikave të mira dhe qasjeve të tjera të integruara ndihmojnë në përmbushjen e këtij qëllimi të përbashkët.

- » **Monitorimi i vazhdueshëm dhe vlerësimi** duhet të shoqërojë të gjithë procesin për të vlerësuar efektivitetin e veprimeve dhe për të identifikuar çdo nevojë për përmirësime dhe rishikime në planifikimin e veprimeve të ardhshme.

2.3 KOORDINIMI ME AKTORË TË JASHTËM

Koordinimi i aktorëve të jashtëm me ata vendorë për identifikimin e të rinjve NEET është një proces thelbësor për të siguruar një qasje të integruar dhe efektive në adresimin e nevojave të kësaj grupmoshe. Kjo përfshin bashkëpunimin dhe koordinimin me OSHC-të, sektorin privat, universitete, donatorë, media etj. Për të koordinuar aktorët e jashtëm me ata vendorë për identifikimin e të rinjve NEET duhet që të bëhet sa më poshtë:

- » **Përcaktimi i Partnerëve Strategjikë** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në adresimin e çështjeve të të rinjve NEET, dhe vendosja e komunikimeve apo përmirësimi i bashkëpunimit me ta në fushën e rintegritimit në arsim punësim apo aftësim.
- » **Krijimi i Forumeve të Koordinimit** nëpërmjet organizimit të takimeve të rregullta mes aktorëve të ndryshëm për të ndarë informacion, për të identifikuar nevojat dhe për të hartuar strategji të përbashkëta për të adresuar sfidat e të rinjve NEET.
- » **Bashkëpunimi në Identifikimin dhe Monitorimin e të Rinjve NEET** duke zhvilluar dhe zbatuar metoda të përbashkëta për identifikimin e të rinjve NEET në nivel lokal dhe për të monitoruar situatën e tyre dhe përparimin e tyre pasi janë identifikuar.
- » **Shkëmbimi i Informacionit dhe Burimeve mes aktorëve** të ndryshëm për të arritur një kuptim më të thellë të situatës së të rinjve NEET dhe për të zbuluar mundësitë për bashkëpunim dhe përmirësim të veprimeve.
- » **Sesione dhe fushata ndërgjegjëse dhe informuese** të inici-

uara nga vetë të rinjtë, të cilat mund të zhvillohen nëpërmjet metodave të shkëmbimit të informacioneve midis bashkëmoshatarëve, të realizuara në shkollë, në qendra rinore, si dhe në vende të tjera përgjatë zhvillimit të aktiviteteve sociale.

- » **Hartimi i Projekteve të Përbashkëta dhe Inicativave** që synojnë të adresojnë sfidat e të rinjve NEET në nivel lokal dhe për të promovuar zgjidhje inovative dhe efektive.

2.4 SHËRBIMET MBËSHTETËSE PËR TË RINJTË NEET

Shërbime mbështetëse për të rinjtë NEET në nivel qendror dhe lokal janë të hartuar për të ndihmuar të rinjtë në përpjekjet e tyre për të gjetur punë, për të përmirësuar aftësitë e tyre, dhe për tu integruar më mirë në shoqëri.

Programet e Formimit dhe Trajnimeve Profesionale

Institucionet e arsimit të lartë dhe qendrat e formimit profesional rajonale dhe vendore ofrojnë programet e tyre për të rinjtë që duan të zhvillojnë aftësi specifike për tregun e punës. Këto programe shpesh përfshijnë trajnime, kurse dhe praktika pune në bashkëpunim me kompanitë dhe bizneset lokale. Pjesë e këtyre shërbimeve janë edhe Programet e Rinovimit të Aftësive dhe Kualifikimeve në të cilat ofrohen trajnime dhe kurse për të rinjtë për të zhvilluar aftësi të reja si edhe për të fituar kualifikime të reja, duke i bërë ata më konkures në tregun e punës. Nga ata tjetër bizneset dhe kompanitë private ofrojnë programe punësimi, mundësi për praktika pune dhe trajnime për të rinjtë NEET.

Programet e Përkrahjes Sociale dhe Ekonomike

Këto programe janë në dispozicion për të rinjtë NEET që kanë nevojë për ndihmë për të përballuar sfidat financiare dhe sociale. Ato përfshijnë ndihmë për pagesën e qirasë, ushqimit, dhe kujdesin shëndetësor. Disa NjVV mund të ofrojnë ndihmë financiare dhe bursa për të rinjtë NEET për të ndihmuar ata që të financojnë arsimin ose vetëpunësimin e tyre si dhe kanë prioritet në programet sociale vendore siç është strehimi social.

Programet e punësimit

Zyrat Vendore të Punësimit dhe NjVV janë ofruesit kryesorë të shërbimeve të punësimit dhe veprojnë si ndërmjetësues mes punëdhënësve dhe të rinjve duke nxitur dhe lehtësuar aksesin e tyre në tregun e punës. Në nivel qendror ka mjaft programe të mbështetjes së start-up-eve rinore, që janë mundësi e mirë për rritjen e mundësive për vetëpunësim. Nga ana tjetër NjVV-të kanë krijuar edhe programet e praktikës së punës dhe punësimit në këto institucione. Në disa prej tyre janë krijuar edhe programet e mbështetjes financiare për të rinjtë, ku nëpërmjet granteve ofrohet financim për vetëpunësim dhe hapjen e bizneseve.

Shërbimet Sociale dhe Mjekësore

Qeveritë qendrore dhe vendore po ashtu edhe OShC-të, qendrat rezidenciale apo komunitare janë entitetet që ofrojnë shërbime sociale dhe mjekësore për të rinjtë NEET, duke përfshirë kujdesin shëndetësor, këshillim psikologjik dhe mbështetje për kategoritë në nevojë apo në risk. Shërbime ofrohen edhe për fëmijët e të rinjtë në situatë emergjence, pa kujdes prindëror, në situatë rruge, me aftësi të kufizuar etj. Pjesë e programeve sociale në nivel vendor është edhe strehimi social ku ofrohen lehtësira dhe mbështetje financiare për stabilizimin e situatës së strehimit. Gjithashtu në nivel vendor janë në dispozicion edhe linjat e këshillimit online.

Shërbimet e këshillimit dhe mentorimit

Qendrat Rinore dhe Zyrat e Këshillimit të Karrierës ofrojnë një gamë të gjerë shërbimesh dhe aktivitësh për të rinjtë, duke përfshirë këshillim, trajnime, kurse, si dhe ofrojnë mundësi për t'u përfshirë në projekte sociale dhe vullnetarizëm. Nga ana tjetër organizatat e shoqërisë civile ofrojnë shërbime këshillimore dhe mentorim për të rinjtë NEET, duke përfshirë ndihmë me hartimin e planeve të karrierës, gjetjen e mundësive për punësim dhe trajnim, etj. Gjithashtu ka programe dhe projekte të financuara nga donatorë të fokusuar në të rinjtë NEET në Shqipëri, që ofrojnë mundësi për trajnim, praktika pune dhe përkrahje për të arritur qëllimet e tyre edukative dhe profesionale.

Platformat informative

Ka platforma online dhe burime informative zyrtare dhe private të cilat of-

rojnë informacion dhe këshilla për të rinjtë NEET në lidhje me mundësitë për arsim dhe punësim, si dhe burime për trajnime dhe ndihma sociale. Shërbimet mbështetëse rrisin mundësitë e të rinjve NEET për të përmirësuar aftësitë e tyre, për të përshpejtuar integrimin në tregun e punës dhe për të përparuar në jetën e tyre profesionale dhe personale. Bashkëpunimi ndërmjet aktorëve publik dhe privat është thelbësor për të siguruar që këto shërbime të jenë efektive dhe mbështetëse.

Në shumë raste, shërbimet që ofrohen nga OSHC për të rinjtë NEET (të rinj të papunë dhe të pa-arsimuar) mund të përafrohen me shërbimet që ofrohen nga institucionet publike. Kjo është e zakonshme për shkak të përpjekjeve të përbashkëta ndërinstitucionale publike dhe private për të adresuar sfidat sociale dhe ekonomike që përballon kjo grupmoshë. Megjithatë, ka disa dallime thelbësore midis shërbimeve të ofruara nga këta aktorë:

- » **Fleksibiliteti dhe Inovacioni:** OSHC-të shpesh janë më fleksibël dhe më inovative në ofrimin e shërbimeve. Ato mund të jenë më të afta për të përshtatur shërbimet e tyre për të përmbushur nevojat e veçanta të individëve NEET dhe për të ofruar zgjidhje më të personalizuar dhe të orientuara drejt rezultateve.
- » **Qasja Lokale dhe Komunitare:** OSHC-të janë më të afërta me komunitetin dhe shpesh kanë një qasje më të drejtpërdrejtë dhe më të personalizuar ndaj nevojave të individëve NEET në nivel lokal.
- » **Ndërveprimi dhe Bashkëpunimi me Qeverinë dhe Sektorin Privat:** OSHC-të janë të rëndësishme për të mbështetur dhe shtyrë përpara agjendat dhe iniciativat qeveritare për të rinjtë NEET. Ata gjithashtu mund të bashkëpunojnë ngushtë me sektorin privat për të siguruar mundësi punësimi dhe trajnimi për të rinjtë NEET.
- » **Zgjerimi i Kufijve të Shërbimeve:** OSHC-të mund të ofrojnë shërbime më të zgjeruara dhe më të specializuara në fusha të caktuara, duke përfshirë shërbime që janë jashtë fushës së veprimtarisë së qeverisë.

Në përgjithësi, një kombinim i shërbimeve të ofruara nga qeveria dhe OSHC-të mund të ofrojë një qasje më të plotë dhe më të pasur për të rinjtë NEET. Bashkëpunimi dhe koordinimi i mirë midis këtyre dy entiteve është thelbësor për të siguruar që shërbimet janë të përshtatshme, të efektshme dhe të mbështetura në mënyrë të qëndrueshme për këtë grupmoshë.